# UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
# PRISHTINË
# FAKULTETI JURIDIK

# E DREJTA ROMAKE (*IUS ROMANORUM*)

**PLANPROGRAMI MËSIMOR**
**(SYLLABUS)**

**PRISHTINË, 2018**

# PLANPROGRAMI MËSIMOR (SYLLABUS)

**LËNDA E DREJTA ROMAKE (*IUS ROMANORUM*)**

**BARTËS TË LËNDËS - LIGJËRUES:**


1. **Prof. Dr. Asllan BILALLI, asllan.bilalli@uni-pr.edu**

2. **Prof. Ass. Dr. Bedri BAHTIRI, bedri.bahtiri@uni-pr.edu**


**VITI I PARË, SEMESTRI VEROR - VITI AKADEMIK 2018**

## I. PËRSHKRIMI I LËNDËS:

E drejta romake është një nga disiplinat tradicionale hyrëse në fakultetet juridike në Evropë, dhe ka për qëllim që studentët t'i pajisë me njohuri të domosdoshme për bazën e përbashkët të sistemeve juridike të Evropës kontinentale. Meqenëse zbatimi praktik i saj ka përfunduar, ajo ka karakterin e disiplinës juridiko-historike me një përmbajtje përafërsisht të unifikuar në shumicën e fakulteteve juridike të universiteteve evropiane.

Esencën e lëndës e sajon materia e cila është e përmbajtur në institucionet e Justinianit dhe përfshin të drejtën private romake në kuptimin të saj më të gjerë (përveç të drejtës pronësore përfshinë edhe njohuri bazike lidhur me të drejtën statusore dhe familjen). Përmes kësaj lënde synohet që të kuptohen parimet dhe mekanizmat e së drejtës romake. Studimi i saj përqëndrohet në krijimin e koncepteve kryesore të së drejtës civile, zhvillimin e mendimit juridik, dhe mjeteve përmes të cilave e drejta është zbatuar në jetën e përditshme. Për më tepër, si hyrje e cila është e domosdoshme për të kuptuar rrethanat në të cilat janë krijuar dhe zhvilluar institutet e së drejtës romake, disiplina e sotme mësimore përmban edhe informata themelore lidhur me zhvillimin e shtetit romak, strukturën shoqërore dhe ekonomike, si dhe njohuri të përgjithshme lidhur me çështjet kryesore të zhvillimit të së drejtës dhe të burimeve juridike.

Në këtë drejtim, rëndësia e lëndës qëndron në rolin e mësimit të së drejtës romake si disiplinë përgatitëse për njohje kreative të së drejtës civile dhe të drejtës private bashkëkohore. Prandaj, kujdes i veçantë i kushtohet të drejtës statusore dhe familjare, të drejtës pronësore, të drejtës së detyrimeve, si dhe të drejtës trashëgimore pa përjashtuar edhe procedurën civile romake, të cilat janë bazë për sistemet bashkëkohore juridike të shteteve të Evropës kontinentale dhe teorinë juridike, ndërsa përmbajtjet tjera i përshtaten këtij qëllimi.

## II. QËLLIMI I STUDIMIT TË LËNDËS:

- fitimi i njohurive lidhur me procesin e krijimit, evoluimit dhe ndryshimeve në institucionet dhe normat e së drejtës romake nën veprimin e rrethanave të ndryshme historike;
- kuptimi i vazhdueshmërisë së traditës juridike të Evropës kontinentale dhe teorisë juridike;
- nxjerrja e përfundimeve të përgjithshme lidhur me rolin dhe ndikimin e së drejtës në zhvillimin historik të shtetit romak;
- njoftimi i studentëve me terminologjinë juridike e cila edhe sot është aktuale;
- njohja me ndikimin e së drejtës romake në të drejtën bashkëkohore të shteteve evropiane, e cila është ndërtuar mbi konceptet dhe normat e së drejtës romake, nëpërmjet pranimit të drejtpërdrejtë ose përmes teorisë baza e së cilës u zhvillua nga mësimi i së drejtës romake nëpër universitete;
- njohja me teknikat e punës së juristëve romak, të cilat paraqesin model me vlera të përhershme kur është fjala për funksionimin praktik të së drejtës dhe përshtatjes së saj nevojave shoqërore.

## III. METODA E LIGJËRIMIT DHE MËSIMIT (STUDIMIT):

Gjatë semestrit çdo javë do të ligjerohet materia e paraparë sipas planprogramit mësimor. Në ligjerata që do të mbahen në mënyrë interaktive do të përfshihen edhe studentët. Studentët mund të punojnë punime seminarike nga materia e përfshirë me planprogram. Punimi seminarik do të prezentohet gjatë ligjeratave me gojë, dhe pastaj do të hapet debati ku do të përfshihen të gjithë studentët. Punimi seminarik i prezentuar me sukses vlerësohet prej 0-20 pikë, që llogariten gjatë formimit të notës përfundimtare.

## IV. VLERËSIMI DHE NOTIMI:

Gjatë vlerësimit të dijes, përkatësisht formësimit të notës përfundimtare vlerësohen komponentat:

1. rregullsia dhe aktiviteti në ligjerata, vlerësohet prej 0-10 pikë;
2. prezentimi i punimit seminarik, vlerësohet prej 0-10 pikë;
3. kollokuimi vlerësohet prej 0-30 pikë;
4. provimi përfundimtar vlerësohet prej 0-50 pikë.

Në fund mblidhen të gjitha pikat dhe formësohet nota sipas tabelës:

| Numri i pikëve | Nota |
|---|---|
| 95 – 100 | 10 |
| 87 - 94 | 9 |
| 77 – 86 | 8 |
| 67 – 76 | 7 |
| 60 – 66 | 6 |
| deri 59 | 5 |

## TEMAT E LIGJERATAVE  QË DO TË LIGJEROHEN GJATË SEMESTRIT

**Java e Parë:**

Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimit gjatë semestrit dhe literaturën.

Vështrim i përgjithshëm i shtetit dhe të drejtës romake. Rëndësia dhe ndikimi i së drejtës romake. Periodizimi dhe ndarja e së drejtës private romake. Burimet e së drejtës romake: Periudha e së drejtës së lashtë, klasike dhe postklasike.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 21-65; 73; 80-84; 91-103; 108-118**

**Java e Dytë:**

**E DREJTA STATUSORE**

Subjektet e së drejtës. Zotësia juridike dhe zotësia e veprimit. Fitimi, përmbajtja, kufizimi dhe humbja e zotësisë juridike. Zotësia e veprimit të personave fizik. Personat juridik.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 119-158**

**Java e Tretë:**

**E DREJTA FAMILJARE**

Familja romake, pozita juridike e anëtarëve të familjes. E drejta martesore: Kushtet për lidhjen e martesës. Pengesat për lidhjen e martesës, fejesa, Format për lidhjen e martesës, marrëdhëniet personale dhe pronësore mes bashkëshortëve. Zgjidhja e martesës. Tutoria dhe kujdestaria. Llojet e tutorisë dhe kujdestarisë.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 159 - 209**

**Java e Katërt:**

**PROCEDURA CIVILE ROMAKE**

Kuptimi dhe krijimi i procedurës civile. Procedura Legis actio, Organet e Procedurës legjsaktore. Procedura in iure dhe apud iudicem. Aktgjykimi, anulimi i aktgjykimit, Ekzekutimi i aktgjykimit. Mjetet e jashtëzakonshme për mbrojtjen e të drejtave subjektive, Interdiktet. Procedura Ekstraordinare.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 209-247**

**Java e Pestë:**

***PROVIMI I NDËRMJETËM*** **(*KOLLOKVIUMI I PARË*)**

**Java e Gjashtë:**

**E DREJTA SENDORE (REALE) I**

Nocioni i sendit. Marrëdhëniet sendore-juridike. Llojet e sendeve. Posedimi. Mbrojtja e posedimit. Kuptimi i pronës private dhe përmbajtja e saj. Kufizimet. Llojet e pronës private.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 247-291**

**Java e Shtatë:**

**E DREJTA SENDORE (REALE) II**

Fitimi i pronësisë. Mënyrat e fitimit të pronësisë. Mjetet juridike për mbrojtjen e pronësisë. Humbja e pronësisë.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 291-327**

**Java e Tetë:**

**E DREJTA SENDORE (REALE) III**

Të drejtat sendore mbi sendet e huaja. Servituti. Pengu.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 328-342**

**Java e Nëntë:**

**E DREJTA E DETYRIMEVE I**

Marrëdhëniet e detyrimeve. Subjektet e marrëdhënieve detyrimore. Përfaqësimi. Ndërrimi i subjektëve.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 343-386**

**Java e Dhjetë:**

**E DREJTA E DETYRIMEVE II**

Përmbajtja e detyrimeve Elementet esenciale. Elementet jo esenciale. Sigurimi i aktiveve. Sigurimi real dhe ai personal. Shuarja e detyrimeve. Përmbushja e detyrimeve dhe pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 387-428**

**Java e Njëmbëdhjetë:**

**E DREJTA E DETYRIMEVE III**

Kontrata si burim detyrimesh, kuptimi dhe klasifikimi i kontratave. Kontratat reale dhe konsensuale: Huaja, huapërdorja, depozita, pengu, shitblerja, qiraja, kontrata në vepër.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake,fq. 429-432; 443-480;**

**Java e Dymbëdhjetë:**

**E DREJTA E DETYRIMEVE IV**

Deliktet si burime detyrimesh. Detyrimet të cilat krijohen nga bazat tjera të ndryshme.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, 501-537**

**Java e Trembëdhjetë:**

**E DREJTA TRASHËGIMORE**

Marrëdhëniet trashëgimore-juridike. Mënyrat e thirrjes në trashëgim. E drejta e domosdoshme e trashëgimit. Fitimi i trashëgimit. Testamenti.

*Literatura:* **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta romake, fq. 538-573**

**Java e Katërmbëdhjetë:**

***PROVIMI I NDËRMJETËM* (*KOLLOKVIUMI I DYTË*)**

**Java e Pesëmbëdhjetë:**

**PROVIMI PËRFUNDIMATARË**

## LITERATURA

### LITERATURA THEMELORE


- **Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, E drejta Romake, Prishtinë 2015**
- **Asllan Bilalli, Fjalor Spjegimor latinisht-shqip, Prishtinë 2015**


### LITERATURA E REKOMANDUAR


- Ivo Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1988.
- Ivo Puhan & Mirjana Polenak - Akimovska, Rimsko pravo, Skopje, 1996.
- Arta Mandro, E drejta romake, Tiranë, 1998
- Barry Nicholas, An Introduction to Roman Law, Oxford, 1975
- Andrew Borkowski & Paul du Plessis, Textbook on Roman Law, Oxford, 2005.
- HF Jolowicz & Barry Nicholas, A Historical Introduction to the Study of Roman Law, 3rd ed., Cambridge, 2008.
- Marijan Horvat, Rimsko pravo, Zagreb, 2007.
- Ante Romac, Rimsko pravo, Zagreb, 2007.
- Ante Romac, Izvori rimskog prava, Zagreb, 1973